

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo
 MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY
 AGENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE AGENCIJA ZA REGISTRACIJU BIZNE SA-BIZNESE SI REGISTRATION AGENCY


Njësia Org.
 Org. Jedin.
 Org. Unit: 11

Nr. Prot.
 Br. Prot.
 Prot. No.: 599

Nr. i faqeve
 Broj stranica
 No. pages: 5

Data:
 Datum:
 Date: 25/06/2024

Prishtinë/a



Administrata Tatimore e Kosovës
 Poreska Administracija Kosova
 Tax Administration of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria Kosovës / Vlada Kosove / Government of Kosovo
 Ministria e Financave dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije i Transfere
 Ministry of Finance and Transfers
 Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo

ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE

Njësia Org.
 Org. Jedin.
 Org. unit: ZQ

Nr. Prot.
 Br. Prot.
 Prot. No.: 09-06-3079

Nr. Faqeve
 Broj stranica
 No. pages: 1

Data:
 Datum:
 Date: 25/06/2024

01 HYRËSE PRISHTINË/A

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

në mes të

AGJENCISË PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË (ARBK)

dhe

ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS (ATK)

Ky memorandum bashkëpunimi është përpiluar mbi bazën e konsultimeve, diskutimeve dhe angazhimeve konkrete të marra nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë dhe Administrata Tatimore e Kosovës me qëllim të ofrimit të mundësisë për qasje online të ATK-së/Departamentit të Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencies, në dosjet elektronike të tatimpaguesve të cilat dosje janë në posedim të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, në funksion të hetimit dhe luftimit të evazionit tatimor dhe veprave të tjera të ndërlidhura penale, si dhe për ngritjen dhe lehtësimin e mëtutjeshëm të koordinimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional.

Për sa i përket më sipër, palët bien dakord të respektojnë qëllimin e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit si më poshtë.

Neni 1

Palët

1. Ky është Memorandum Bashkëpunimi (këtu e tutje Memorandumi) ndërmjet Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (këtu e tutje ATK).

2. ARBK sipas Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare është organ qendror i administratës shtetërore që funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që merret me regjistrimin e shoqërive tregtare dhe emrave tregtar si dhe është e autorizuar për kryerjen e funksioneve tjera të përcaktuara me këtë Ligj apo edhe funksione të përcaktuara për ARBK-në edhe me ligje të tjera.

3. ATK-ja sipas Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L102 dhe Nr. 04/L-223 është përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji, Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, Ligjit për Tatimin në të Ardhurat nga Korporatat, Ligjit për Tatimin në Vlerën e Shtuar dhe çdo legjislacioni tjetër të zbatueshëm në Kosovë, e që i ngarkon detyrën të administrojë çdo lloji tatimi.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është ofrimi i mundësisë për qasje online të ATK-së/Departamentit të Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencies në dosjet elektronike të tatimpaguesve, të cilat dosje janë

në posedim të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me qëllim të hetimit dhe luftimit të evazionit tatimor dhe veprave të tjera të ndërlidhura penale, si dhe për ngritjen dhe lehtësimin e mëtutjeshëm të koordinimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional

Neni 3 Fushëveprimi

1. Ky Memorandum vendos natyrën dhe nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet ARBK-së dhe ATK-së.
2. Ky Memorandum po ashtu vendos procedurat, kushtet dhe kriteret për lehtësimin e qasjes së hetuesve tatimorë në të dhënat e tatimpaguesve përmes kanaleve të sigurta ndërmjet ARBK-së dhe ATK-së.
3. Dispozitat e këtij Memorandumi, po ashtu edhe kërkesat tjera ligjore duhet respektuar nga të dy palët nënshkruese.

Neni 4 Zotimet dhe detyrimet ndërmjet palëve

1. Të dy Palët zotohen ta shqyrtojnë me kujdes çdo kërkesë formale që i bëjnë Palës tjetër, që të sigurohen se kërkesa është e arsyetuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi. ATK-ja zotohet t'i përdorë të gjitha materialet dhe informatat e pranuar nga ARBK sipas këtij Memorandumi vetëm për qëllime të aktiviteteve të hetimeve tatimore, ashtu siç autorizohet me Ligjin në fuqi Administratën Tatimore dhe Procedurat.
2. Palët pajtohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi, me qëllim të hetimit të rasteve që dyshohen për evazion tatimor, veprave tjera të ndërlidhura penale, si dhe luftimin e informalitetit.
3. *Përgjegjësitë e ATK-së:*
 - 3.1. ARBK-ja angazhohet që të vërë në dispozicion të ATK informacione apo të dhëna relevante që disponon, që janë me interes dhe ndërlidhen me punën e ATK dhe në harmoni me qëllimet e këtij Memorandumi;
 - 3.2. të caktojë një pikë të përbashkët kontakti për komunikim ndërmjet Palëve.

3.3. të mbajë të gjitha të dhënat e pranuar nga ARBK-ja në një bazë të sigurt të të dhënave dhe t'i përdorë ato vetëm për qëllime të hetimeve tatimore dhe inteligjencës dhe në pajtim me këtë Memorandum dhe legjislacionin në fuqi.

4. Përgjegjësitë e ARBK-së:

4.1. ARBK angazhohet të vërë në dispozicion të ATK-së informacione apo të dhëna relevante që disponon, që janë me interes dhe ndërlidhen me punën e ATK-së dhe në harmoni me qëllimet e këtij Memorandumi;

4.2. ARBK-ja zotohet se përmes një linku të sigurt do t'ju mundësojë zyrtarëve të autorizuar nga ATK-ja qasje në dosjet individuale të tatimpaguesve të cilat janë të arkivuara në formë elektronike;

4.3. t'u përgjigjet kërkesave për qasje të ATK-së të cilat mund të shërbejnë vetëm për qëllime të hetimeve tatimore dhe inteligjencës dhe me qëllim të analizimit të të dhënave tatimore të inteligjencës dhe aktiviteteve tjera brenda autoritetit të ATK-së; në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e përcaktuara në këtë Memorandum;

4.4. të caktojë një pikë të përbashkët kontakti për komunikim ndërmjet Palëve (detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit do të specifikohen në një dokument tjetër).

Neni 5

Procedura e qasjes së informatave në formë elektronike

Procedura e qasjes, përkatësisht mundësisë së shpalosjes së informatave nga ana e ATK-së në dosjet elektronike të ARBK-së do të specifikohet përmes një dokumenti/manuali teknik, që do të përgatitet nga ARBK-ja dhe do të dorëzohet në mënyrë formale për përdoruesin e NJHTI në ATK.

Neni 6

Kushtet e përdorimit të informatave të pranuar

1. Të gjitha të dhënat, informacionet dhe dokumentet zyrtare të cilat vihen në dispozicion nga ARBK tek ATK do të përdoren vetëm për qëllime të hetimeve tatimore dhe inteligjencës, me qëllim të ofrimit të bazës për hetime, mirëpo ato nuk mundë të përdoren si prova para një gjykate.

2. Informatat e pranuar, sipas këtij Memorandumi janë të natyrës së besueshme dhe do të përdoren vetëm për qëllimet e parapara në këtë Memorandum. Nuk mund të bëhet asnjë përdorim tjetër ose

shpërndarje e informatave pa konsultim paraprak dhe autorizimin me shkrim të Palës që i ofron informatat.

Neni 7

Fillimi, zgjerimi dhe mbarimi i bashkëpunimit

1. Memorandumi do të jetë në fuqi nga data e nënshkrimit deri në përfundim ose deri sa të zëvendësohet nga ndonjë memorandum ose instrument tjetër.
2. Memorandumi mund të përfundohet nga secila Palë duke njoftuar paraprakisht me shkrim 30 ditë më herët, ndërsa mund të plotësohet dhe ndryshohet vetëm pas marrëveshjes me shkrim nga të dyja Palët.
3. Në rast të përfundimit procedurat, kushtet dhe kriteret lidhur me përdorimin dhe shpërndarjen e informatave të shkëmbyera sipas këtij Memorandumi vazhdojnë të jenë në fuqi dhe janë detyrues për Palët sa i përket informatave të marra nga Pala tjetër sipas këtij Memorandumi para përfundimit.
4. Palët pajtohen që çdo mosmarrëveshje apo keqkuptim ta zgjidhin me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjellë si dhe bazuar në ligjet në fuqi.
5. Ky Memorandum do të nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

Për: Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve



(emri mbiemri, nënshkrimi)

Për: Administratën Tatimore të Kosovës



(emri mbiemri, nënshkrimi)

Prishtinë, 25 /06/2021